



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 1450/1 Prot.

Tiranë, më 15/2/2019

URDHËR

Nr. 56, Datë 15/2 2019

“PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 15 “PËR KONTABILITETIN DHE RAPORTIMIN FINANCIAR TË MIKRONJËSIVE EKONOMIKE” I PËRMIRËSUAR”

Në mbështetje të nenit 3, pika 5, të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të nenit 11, pika 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 15 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike”, i përmirësuar (SKK 15).
2. Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 15, i përmirësuar, do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël që fillon më ose pas datës 01.01.2019. Ndryshimet zbatohen në prospektivë.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

